



UNIVERSITETI I GJAKOVËS
"FEHMI AGANI"
UNIVERSITY OF GJAKOVA

Rr. Ismail Qemali, pn 50 000 GJAKOVË, Republika e Kosovës
Tel: 038 200 20 831; www.uni-gjk.org

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

Nr.Prot.: 05/245
Datë: 27/02/2020

Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", bazuar në nenin 12 paragrafi 1 pika 1.15 dhe nenin 22 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani, në mbledhjen e mbajtur më 24.02.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Instituti për Mjedis dhe Shëndet në kuadër të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani".
- II. Funksonimi i Institutit për Mjedis dhe Shëndet do të bëhet pasi të miratohet Rregullorja e Institutit, nga Këshilli Drejtues, përgjegjësit dhe çështjet si:
Fushëveprimtaria, të hyrat, shpenzimet, stafi i punësuar e tjera duhet t'i përmbaj Rregullorja e Institutit, që do ta miratojë Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh rolin dhe rendësin e Institutit për Mjedis dhe Shëndet, i cili themelohet në kuadër të Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", me qëllim të kryerjes së aktiviteteve hulumtuese shkencore, ofrimin e shërbimeve eksperimentale në fushën e mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit dhe në avancimin e kapaciteteve akademike për mësimdhënie më efektive dhe më cilësore, Këshilli Drejtues i Universitetit të Gjakovës në parim pajtohet për themelimin e këtij instituti, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Menaxhmentit;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. Ueb faqes së UGJFA-së;
5. Arkivit të UGJFA-së.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Mazllom Kumnova

